



REPUBLIKA E SHQIPËRIS
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

VENDIM

Nr. 70 Datë 28.12.2009

PER
MIRATIMIN E NIVELIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE TË VITIT 2010
PËR BASHKINË LEZHË

Bazuar ne ligjin nr. 8652, date 31.07.2000 “Per organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, nenet 16 e 32, në ligjin nr 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” si dhe ne ligjin nr 9920, date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”,ligjin nr.10117 datë 23.04.2009,dhe në ligjin nr 10146 datë 28.09.2009 ”Për disa ndryshime në ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave Vendore” me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe pas diskutimit të antarve të Këshillit, Këshilli i Bashkisë Lezhë .

VENDOSI:

Neni 1:

Me perjashtim te rasteve kur eshte shprehur ndryshe, termat e perdorur ne kete Projekt. kane te njejtin kuptim qe ato kanë në ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar me ligjin nr 10117 datë 23.04.2009 dhe me ligjin nr.10146 datë 28.09.2009, si dhe ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise” dhe udhezimit të Ministrisë së Financave nr.24 datë 02.09.2008

1.1 Për efekt të zbatimit të paketës fiskale, lidhur me aplikimin e tarifave të pastrimit e largimit të mbeturinave urbane,taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja ,si dhe tarifa dysheme për lëshimit me qera të ambjenteve pronë e bashkisë ,territori i Bashkisë ndahet në dy zona (A dhe B) : (Sipas ndarrjes së miratuar në VKB. Nr.66 datë 19.12.2007 ,2009 ,VKB.nr 67 datë 15.12.2008)

Neni 2:

Niveli i taksave sipas kategorive dhe nenkategorive, agjenti tatimor, kështet e pagesës, madhësia dhe koha e pagimit përcaktohen si më poshtë:

2.1. Taksa vendore mbi biznesin e vogel percaktohet:

ne 000/lek

Nr	EMERTIMI AKTIVITETIT	NIVELET E XHIROS						
		Deri 2000	2000- 3000	3000- 4000	4000- 5000	5000- 6000	6000- 7000	7000- 8000
1	Shitje me pakice	25	48	63	78	93	108	123
2	Shitje me shumice	25	48	63	78	93	108	123
3	Prodhim	23	45	60	75	90	105	120
4	Sherbime	20	43	58	73	88	103	118
5	Profesione te lira	30	53	68	83	98	113	128
6	Ambulant	5	-	-	-	-	-	-

2.1.1. Per automjetet e transportit te udhetareve, taksa paraqitet si me poshte:

000/ lek

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 5 vende	19
2	Automjete 6-9 vende	38
3	Automjete 10-25 vende	44
4	Automjete 26-42 vende	49
5	Automjete mbi 42 vende	52

2.1.2 Për automjetet e transportit të mallrave, taksa paraqitet si më poshtë:

000/lek

Nr	Lloji i automjetit	Niveli i takses
1	Automjete deri 2 ton	28
2	Automjete 2-5 ton	40
3	Automjete 5-10 ton	48
4	Automjete 10-16 ton	50
5	Automjete mbi 16 ton	75

2.1.3 a-Kjo takse paguhet ne kater keste të barabarta, në afatet e mëposhtme;

- Kësti parë jo më vonë se data 20 prill
- Kësti dytë jo më vonë se data 20 korrik
- Kësti tretë jo më vonë se data 20 tetor
- Kësti katert jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal.

2.1.3 b-Përfitojnë lehtësi tatimore në masën 10% ato biznese që bëjnë pagesën e plotë vjetore brenda datës 20 Prillë, të vitit fiskal në vijim.

2.1.4. Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

2.1.5 Kundervajtjet administrative, sanksionet dhe e drejta e ankimit sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr.9931 dt.09.06.2008 dhe ligjin Nr.9920 dt.19.05.2008.

2.2 Taksa mbi ndertesat.

Llogaritet mbi bazën e sipërfaqes së ndërtimit në pronësi të taksapaguesit, përfshirë sipërfaqen mbi e nën tokë ose për çdo kat.

Nivelet treguese te takses mbi ndertesat percaktohen si me poshte:

Lek/m² ne vit

Nr	Kategoria / Nenkategoria	Niveli i Takses
1	Ndertesat banimi	
•	Ndertuar para vitit 1993	10
•	Ndertuar gjate ose pas vitit 1993	12
2	Ndertesat tjera	
•	Per tregti (me pakice dhe shumice)dhe sherbime të tjera të gjitha llojeve	150
•	Për sherbime administrative dhe profesione të lira dhe ndertesat social kulturore	130
•	Ndertesat në sherbim të aktiviteteve prodhuese përpunuese,	30
•	Ndertesat në sherbim të OJF- ve	30

2.2.1 Siperfaqja në pronësi të çdo subjekti tatimpagues përcaktohet mbi bazën e dokumentacionit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Për objektet që mungon një dokumentacion i tillë kjo sipërfaqe përcaktohet me komision të posaçëm, në zbatim të VKB.nr.28 datë 27.06.2007 dhe urdherit të Kryetarit të Bashkisë nr.68. datë 17.07.2007.

2.2.2 Për vjeljen e kësaj takse ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Lezhë.

2.3 Taksa e fjetjes në hotel.

Paguhet nga klienti që strehohet në hotel dhe shënohet në faturën e hotelit si zë me vete. Mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë dhe derdhet në favor të saj çdo datë 5 të muajit pasardhës.

Masa e kësaj takse është 5% e çmimit të fjetjes.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Lezhë çdo muaj duhet të rakordojë me subjektet përkatëse për derdhjen e taksës si dhe të ushtroje kontrolle sistematike për dokumentimin e saj, prej tyre.

2.4 Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja:

Percaktohet mbi bazën e vlerës në lek të ndertimit të ri e koeficientëve në përqindje si më poshtë:

Nr	Kategoria /Nenkategoria	Koeficienti në % ndaj vlerës së ndertimit Zona A	Koeficienti në%ndaj vlerës së ndertimit Z.B
		Zona A	Zona B
1	Objekte banimi	1,5	1
2	Objekte shërbimi e tregtie	3	2
3	Objekte arsimore, shëndetësore, shkencore, administrative e socialkulturore	2	1.5
4	Investime në infrastrukturë	0.1	0.1
5	Për legalizimin e banesave, ALUIZNI	0.5	0.5

Kjo takse paguhet nga investitori në një kësht në momentin e leshimit të lejes së ndertimit. Në rast të mos pagesës në afat të kësaj takse aplikohet kamata vonesa 0.2 % e shumës që duhet të paguhet deri në 60-ditë, me kalimin e këtij afati kamata llogaritet 1% deri në 30 dite. Në rastet se shkelet edhe ky afat KRT-ja vendos masa të tjera deri në anulimin e lejes së miratuar.

Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Urbanistikës e Bashkisë Lezhë.

2.4. Taksa për zënien e hapësirave publike.

Kjo takse përcaktohet nga Drejtoria e Tatimit Taksave mbi sipërfaqen në meter katror që do të jepet për përdorim, pasi të jetë aprovuar kërkesa e subjektit, dhënë leja e shfrytëzimit.

- Zënie e hapësirës publike për qëllime biznesi në tregjet publike të administruara nga bashkia 99 lekë m²/në muaj./

2.4.1 Pagesa e kësaj takse bëhet me kësht mujore, me parapagim në momentin e lidhjes së kontratës me Bashkinë Lezhë.

2.4.2 Ngarkohet për vjeljen e kësaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore.

2.4.3 Zënia pa leje e hapësirave publike dhe moskryerja e pagesave paraprake si më sipër denohet si kundërvajtje administrative sipas legjislacionit në fuqi. Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Policia Bashkiake ushtrojnë kontrolle periodike lidhur me zënien e hapësirave publike për qëllime tregtimi.

.6 Taksa e tabelës.

Percaktohet si detyrim vjetor në lek i subjekteve mbi bazën e kategorive dhe nenkategorive të mëposhtme:

Nr	Kategoria /Nenkategoria	Niveli i Takses
1	Tabele për qellime identifikimi fizik/juridik	120 /lek /vit
2	Tabele për qellime reklamimi,të thjeshta dhe elektronike	22 500 /lekë/m2/vit
3	Tabele në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj	1 000/lekë/m2/ditë

Detyrimi për tabelën paguhet brenda datës 20 Prill të vitit fiskal, ose në momentin e hapjes së aktivitetit. Detyrimi për reklamen paguhet në një kësht në momentin e marrjes së lejes për vendosje. Ngarkohet për mbledhjen e kësaj takse Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Neni 3

Tarifat vendore.

Llojet, kategoritë, nenkategoritë, baza, kështet, koha e pagesës dhe organi që ngarkohet me mbledhjen e tyre përcaktohen si më poshtë:

3.1. Tarifa e pastrimit dhe e largimit të mbeturinave.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave për kategorinë familjare llogaritet e ndarë në zonë A dhe B duke ju referuar nivelit të shërbimit që ofrohet secilës zonë,gjithashtu edhe për subjektet juridike zbatohet ndarja në zonë . Ndarja në zonë është e njëjtë me përcaktimin e bërë në vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr .66 datë 19.12.2007 dhe nr.67 datë 15.12.2008.

KATEGORIA FAMILJAR

Nr	KATEGORIA/NENKATEGORIA	Taksa në lek/vit	
		ZONA A	ZONA B
1	Kategoria familjare:		
	● Familje në ndihmë ekonomike, familje me kryefamiljar invalid, veteran të luftës apo që ka statusin e jetimit.	600	200
	● Familje të tjera	1.300	500

Për banorët që kanë likuiduar detyrimet për taksat dhe tarifat familjare t'u shërbehet pa pagesë për, vertetimet banor i qytetit ,apo ndonjë vertetim tjetër, sipas kërkesave të institucioneve ,në mbështetje të legjislativës.

Ne lekë

Nr.	Aktivitetet/Tarifat	Deri në 2000	2000-3000	3000-4000	4000-5000	5000-6000	6000-7000	7000-8000
1.	Shitjet me pakicë	2500	4800	6300	7800	9300	10800	12300
2.	Njësi Prodhimi	2300	4500	6000	7500	900	10500	12300
3.	Sherbime	2000	4300	5800	7300	8800	10300	12000
4.	Profesione të lira	3000	5300	6800	8300	9800	11300	12800

Detyrimi paguhet në një kestë Brenda datës 20. Prillë Për subjektet fizike sipas tabes së sipershenuar , ose në momentin e lindjes fillestare të detyrimit..

Tarifat e pastrimit dhe largimit të mbeturinave Për subjektet Juridike (Biznes i madh)

Nr.	Llojet e bizneseve	Tarifa në lekë/vit Zona A	Tarifa në lekë/vit Zona B
I	- Magazina të tregtimit me shumicë e pakicë (Markete Ushqimore)	40000	30000
	- Magazina të tregtimit me shumicë e pakicë (Markete Jo ushqimore)	30000	20000
II	Njësi sherbimi		
	- Bar –Kafe, Internet Kafe , pube	20000	15000
	- Restorante , Fast –Foode ,Piceri, Pastiçeri etj.	40000	30000
	- Diskoteka e lojra Fati etj.	35000	25000
	-Pika servisi të automjeteve	40000	30000
	-Elektroshtëpiake, Kasetofona, foni, Sallone bukurije (parukeri),robaqepsi	20000	10000
III	Njësi Prodhimi		
	-Prodhim Tregtim Tulla,Blloqe betoni ,gelqere, inerte	50000	25000
	-Prodhime e punime druri,hekuri, e duralumini	40000	30000
	-Prodhime Ushqimore , Bukë ,Mish,Peshk, Bumet etj.	40000	30000
	-Thertore , perpunim tregtim vjajrash, naftë, Gazi e nënprodukte të tyre Shtypshkronja etj.	40000	30000
IV	Subjekte Ndertuese		
	-Për selit administrative	20000	10000
	-Ndertim objekte të reja nga një deri në pes kate (Ngritje kantieresh)	50000	30000
	- Ndertimet mbi 5 kate	100000	70000
	Profesionet e lira, institucionet arsimore, shendetesore, kulturore e sportive private	8000	6000
	Hotele, motele, komplekse turistike, zyra administrative etj, te ngjashme me to ne lek/dhome/vit	500	300

Afati i pagese deri 31.03.2010 për të gjitha subjektet juridike ..

Të ardhurat e siguruar evidentohen ze me vete dhe perdoren vetem per permiresimin e ketij sherbimi. Ngarkohet per mbledhjen e kesaj takse Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendor

3.2 Tarifa e parkimit te automjeteve.

Per parkimin e automjeteve ne vendparkimet publike me pagese percaktohen tarifat si me poshte:

Nr	Kategoria e automjeteve	Tarifa ne lek sipas kohes se parkimit	
		Lek/1 deri 3 ore	Parkim i rezervuar/vit
1	Autobuza	200	15000
2	Minibuza	100	10000
3	Autovetura	50	6000
4	Kamione deri 3,5 ton	100	0
5	Kamione 3,5-8 ton	150	0
6	Kamione 8-16 ton	200	0
7	Kamione mbi 16 ton	200	0
8	Automjete me rimorkjo, trailera	300	0

Meqense kamjonëve të transportit nuk u sigurojme parkim të rezervuar nuk kemi parashikuar tarifa të tilla .

Per vjeljen e te ardhurave per vendet e rezervuara ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3.2.1. Tarifa maksimale për transportin e udhëtarve me taksi në zona urbane nga ora 06:00-21:00.

- a).Tarifa fillestare për distancën deri në 2 Km. 300/lekë për çdo udhëtar shtese nga nisja ,shtesa në lekë nga taksisti duhet të jetë 150/lekë
- b).Tarifa për distancën deri në 14/km 1600 ose 114.3 /lekë/km
- c).Tarifa mbi 14km deri në 30Km 3400 ose 118/lek ë/Km
- d).Tarifa mbi 30 /Km 153 lekë për çdo Km

3.2.2. Tarifa maksimale të udhëtimit në zonat jo urbane nga ora 06:00 – 21:00.

- a).Tarifa fillestare deri në 2km 350/lekë për çdo udhëtar shtesë 50% e tarifës fillestare.
 - b).Tarifa deri në 14 Km 1350/lekë ose 96.4/lekë për Km.
 - c).Tarifa mbi 14 Km deri 30Km 2950/lekë ose 92/lekë për Km.
 - d).Tarifa mbi 30 km. Udhëtim 133/lekë për Km i shtohet çmimit të udhëtimit deri në 30Km.
- Për çdo udhëtim në tarifimin e taksimetrit nga drejtoria e kalibrimit vëndoset tarifa fillestare e udhëtimit deri në 2Km e para plus sipas distancës përshkruar në pikat b,c,d,.
- Për.sherbime të kryera pas ores 21:00 deri në oren 06:00 si dhe në ditet e djela e festa zyrtare çdo tarife udhëtimit t'i shtohet 10% e vlerës.

• 3.3.Tarifa per sherbimet administrative:

3.3.1Sherbimi i arkives.

- Ekstrakt vendim keshilli e vertetime të arkivit 100 lek
- Dokument vertetim pronesia 200 lek

3.3.2.Tarife sherbimi per tregjet publike:

- Shites artikuj industrial 1.000 lek/muaj
- Shites artikuj ushqimore 1.500 lek/muaj
- Shites artikuj bulmeti e mish 2.000 lek/muaj
- Shites ditore 100 lekë/ m2/ në ditë

Agjenti tatimore eshte punonjesi qe ndjek shfrytezimin e tregut publik, sipas kontrates me Bashkine Lezhe. të jetë subjekt i regjistruar në organet tatimore , dhe të likujdoje detyrimet tatimore.

3.3.3Per dhenien e licensave perdoren tarifat si me poshte:

- Dhenie çertifikate transport mallrash e pasagjeresh 2.000 lek
- Dhenie autorizimi per transport nderqytetas 2.000 lek
- Autorizim shitje karburanti me pakice 50.000 lek
- Leje per sherbim me orar te zgjatur apo 24 oresh 10.000 lek/muaj.
- Në të gjitha rastet lejet e sherbimit me orar të zgjatur do të jepen për ato lokale që plotësojnë kushte, si eliminimin e zhurmave(ndotjen akustike),të mos krijojnë shqetësime për banoret për rreth.

Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

3.3.4Tarifa ne fushen e urbanistikes

- Pranim dosje per shqyrtim per te gjitha llojet e aplikimeve per nevoja biznesi 5.000 lek
per shtepi banimi 2.000 lek
për ndryshim destinacioni 2 000 lekë
- Terheqje dokumentash te njesuar me origjinalin nga arshiva teknike dhe ajo e kadastres urbane 100 lek/dokumenti
- Tarifa për Fasaden e objekteve 30/lek/m2
- Kontroll i piketimit te objekteve 5.000 lek

Kontroll i piketimit te objekteve shtepi banimi 2.000 lek

- Kontroll pas perfundimit te themeleve 5.000 lek per shtepi banimi 2.000 lek
- Kontroll pas perfundimit te karabinase 1.500 lek/kat
- Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues pas perfundimit te punimeve 1.000 lek
- Akt kontroll i perfundimit te punimeve per leje shfrytezimi: objekte deri 5 kate 8.000 lek
objekte mbi 5 kate 8.000 lek + 1000 lek/kat
- Fotokopjim planshetash ne shkallen 1/500; 1/200
format A4 100 lekë
format A3 200 lekë
format A2 400 lekë
format A1 1.000 lekë
format A0 2.000 lekë
- Azhornim genplanesh per leje ndertimi 40 lek/m²; ne objektet e veçuara 10 lek/m²
- Genplan i paazhornuar format A4=1000 lek; format A3= 2000 lek
- Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit, azhornim i genplanit 3000 lek
- Azhornime per reklama e zenie hapësirash publike 2.000 lek

Per vjeljen e ketyre tarifave ngarkohet Drejtoria e Urbanistikes.

3.3.5 Tarifa te inspektoriatit veterinar:

- Çertifikate lejim konsumi te peshkut e produkteve te detit 100 lek/rast
- Vulosja e mishit dhe paisja me raport veterinar per kafshet e trasha 100 lek/krere
- Vulosja e mishit dhe paisja me raport veterinar per derrat e kafshet e imta 100 lek/krere
- Të vendoset tarifa për lejen veterinarë për të gjitha subjektet juridike, fizike, të stabilimenteve, të lokaleve të tregtimit, mjeteve të transportit, magazinave, frigoriferve për produktet, nënproduktet blektorale dhe peshkut në masen 1000 lekë.

3.3.5.1 Të vendoset tarifa për punë të kryer veterinarë, për kontrollin klinik të kafsheve e shpendëve të gjalla që tregtohen brenda teritorit të Bashkisë, si më poshtë vijon :

- a) Për një kokë gjedhi të gjallë 500/lekë
- b) Për një derr të gjallë 200/lekë
- c) Për një kokë të imët 200/lekë
- d) Për një parti malli shpendësh deri në 100 krerë 500/lekë
- e) Për një parti malli shpendësh mbi 100 krerë 1000/lekë

3.3.5.1. Në zbatim të ligjit për “Kundravajtjet administrative”, për çdo kundravajtje e shkelje të legjislacionit veterinar, ushqimor dhe të mjedisit, të vendoset masa e gjobës nga 500 deri në 10000/lekë.

3.3.5.2 Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet inspektoriatit veterinar.

3.3.6. Tarifa sherbimi per institucionet e varesise:

3.3.6.1. Drejtoria e Muzeut Historik. Hyrja ne muze behet me bileta ne vlerat e meposhtme:

- Femije 50 lek
- Te rritur 100 lek

3.3.6.2 Pallati i Kulturës “Manush Alimani”:

- Salla e leksioneve 3.000 lek/ora
- Salla e madhe 20.000 lek/ora
- Per shfaqjet të organizuara nga institucioni për per publikun 200 lek/person
- Përdorimi i sallave për zhvillime provash 300/lekë /ora .
- Salla e Galeris së arteve Lekë/ditë/përdorimi për ekspozita 3 000/lekë
- Për piktoret e rinj e talentet e reja 1000/lekë /ditë

3.3.6.3. Bibloteka Publike Qytetit.

- Holli në katin e dytë Lekë/ditë/përdorimi 3 000 lekë/ditë
- Hapje kartele lexuesi të rregullt 100 lekë
- Hapje kartele lexuesi për fëmijet -

3.3.6.4 Klubi shumesportesh “Beslidhja”:

a) **Ndeshje kombetare:**

- Tribuna A e B (e mbuluar) 200 lek
- Tribuna A e B(e pambuluar) 150 lek
- Tribuna perball 100 lek

b) **Ndeshje nderkombetare:**

- Tribuna A e B (e mbuluar) 500 lek
- Tribuna A e B (e pambuluar) 400 lek
- Tribuna perball 300 lek

c) Per dhenien ne shfrytezim te mjediseve sportive tarifa eshte 50.000 lek/aktivitet

3.3.6.5. Ngarkohen per mbledhjen e ketyre tarifave administrata e institucioneve vartese, si dhe drejtoria e finances per evidentim e kontroll.

3.3.6.6. Pë dhenjen me qera të objekteve pronë e Bashkise të zbatohet VKM .nr.1712 datë 24.12.2008, VKB. Nr.67 datë 15.12.2008, rekomandimete e KLSH.-së duke ruajtur ndarjen në zona .

-Zona A 250/lekë m2

- Zona B 150 /lekë m2

Këto çmime konsiderohen si çmime dysheme .

Neni 4

Në reakordim me komunitetin e biznesit të përcaktohen oraret e shërbimit, dita e pushimit për çdo njësi të tregëtisë me pakicë e shumicë, njësi shërbimi e prodhimi .

Neni 4/1

4.1 Mospagesa në afat e taksave , tarifave vendore dhe moshlyerja e detyrimeve të tjera të percaktuara sipas kësaj pakete , konsiderohen kundravajtje administrative , dhe denohen sipas ligjislacionit në fuqi..

Neni 5

Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Tatim Taksave, Drejtoria e Sherbimeve, Drejtoria e Urbanistikes, Drejtoria e Finances, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Drejtuesit e Institucioneve vartese

Neni 6

Policia Bashkiake ngarkohet te mbeshtese sipas rregullave te percaktuara ligjore, inspektoret e tatimeve dhe drejtorite e zyrat e tjera ne realizimin e te ardhurave nga taksat e tarifate vendore.

Neni 7

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes ,në përputhje me nenin 33 të ligjit nr..8652 datë 31.07.2000” Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes Vendore” dhe i shtrin efektet financiare nga data 01. janar 2010.

KRYETARI

FRANO KULLI